



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01 Nr. 060/01-31222/25
Kaçanik, 30.12.2025

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 3.1 dhe 2 lidhur me nenin 4, 5 dhe 6.4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 – për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e datës 30 dhjetor 2025, merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA


- Me këtë Vendim, formohet Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) i Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:

1.1. Selajdin Troni	PDK	Kryesues sipas funksionit
1.2. Bashkim Krasniqi	PDK	anëtar
1.3. Lejla Muhaxheri Çaka	PDK	anëtar
1.4. Kadrije Lika Troni	LVV	anëtar
1.5. Ernesta Krasniqi	LVV	anëtar
1.6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
1.7. Kjani Zeneli	VZHK	anëtar.
- Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa reflekton përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës, duke reflektuar edhe barazinë gjinore.
- Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, sipas funksionit që e ka. Në rastet kur në mbledhjen e komitetit për politikë dhe financa mungon kryesuesi, mbledhja kryesohet nga anëtari më i vjetër i komitetit.
- Detyrat e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit.
- Anëtarët e KPF nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.
- Kompensimi për punën e Komitetit për Politikë dhe Financa bëhet sipas Ligjit në fuqi për Paga në Sektorin Publik.
- Ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, përkatësisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Personelit, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbilin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 13.01.2026 VI-020-701
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e kuvendit të komunës në vijim:

Vendim 01 Nr. 060/01-31222/25 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa
I miratuar më datë: 30.12.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.12.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2025, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 060/01-31222/25 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, është bazuar në nenin 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Komunave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës 04 Qershor 2008), në nenin 3.1 dhe 2 lidhur me nenin 4, 5 dhe 6.4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, dhe në nenin 39.1 të Statutit të Komunës, me të cilin vendim është themeluar Komiteti për Politikë dhe Financa.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datë 30.12.2025, është miratuar më 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.